

Datë 04 / 11 / 2021

INFORMIM

NGA: “Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë” **NAREA**, Organizatë Jo-Fitimprurëse me Anëtarësi, Themeluar datë **26/11/2015** në Tiranë, e regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë **Nr. 5227**, datë **22/01/2016**, me Numër Unik Identifikimi të Subjektit **NIPT M12222452E**, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Reinaldo Pipiria, madhor dhe me zotësi për të vepruar, me Numër Unik Identifikimi Personal **NID I31008047W**, me seli në adresën Rruga e Elbasanit, Pallati 10/1, Kati 1, Apartamenti 3, Njësia Administrative 2, Tiranë, këtu e më poshtë referuar si **(NAREA)**

DREJTUAR: Kujtdo që mund t’i interesoj

LËNDA: Shprehje shqetësimi në lidhje me procesin konsultativ të Projektligjit “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”

Të nderuar,

Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë (**NAREA**), është shtëpia e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, Brokerave dhe Rrjeteve të Franshizave që operojnë në Shqipëri. **NAREA** synon Promovimin e Biznesit të Ndërmjetësimit të Pasurive të Paluajtshme, Zhvillimin & Strukturimin e Sektorit të Pasurive të Paluajtshme, Përfaqësimin Profesional të Interesave të Aktorëve në treg, si dhe të Udhëheqë drejtë Standardeve të Larta të Etikës në Biznes.

Mbështetur në Themelin dhe Misionin e **NAREA**, dëshirojmë të ndajmë me ju dhe më gjerë, se si komunitet Sipërmarrësish dhe Punëdhënës, jemi thellësisht të shqetësuar për klimën, frymën dhe nxitimin në të cilën po tentohet të zhvillohet procesi konsultativ në lidhje me Projektligjin “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”.

Gjatë ditës së djeshme (**3 Nëntor 2021**), pothuajse në përfundim të orarit zyrtar, jemi njoftuar nga Ministria e Drejtësisë për një takim përmbyllës konsultativ ditën e premte, **datë 5 nëntor 2021**, duke lënë kështu në dispozicion, për të konsultuar paraprakisht një Projektligj kaq të rëndësishëm për ne, vetëm 1 ditë pune. Marrë në konsideratë këtë, e bën të pamundur dhënien e një kontributi ndërtues nga komuniteti i biznesit të **NAREA**.

Si **NAREA** shprehim jo vetëm shqetësimin tonë por dhe kërkesën ndaj Ministrisë së Drejtësisë, si institucion ligj hartues, që të marrë në konsideratë krijimin e hapësirës kohore të nevojshme, duke mos nxituar të përmbyll Konsultimin dhe vetë Projektligjin në fjalë, për të ndërtuar bashkërisht një Ligj të qëndrueshëm në kohë dhe që i shërben të gjithë aktorëve në këtë proces.

NAREA dëshiron të ndaj dhe me ju, se mbetet e përkushtuar që të japë kontributin ndërtues, si dhe të udhëheqë nëse është e nevojshme, drejtë standardeve më të larta të një kuadri Ligjor dhe Rregullues të Ndërmjetësimit të Pasurive të Paluajtshme. Ne dëshirojmë kështu mirëfunksionimin e këtij sektori sipas praktikave më të mira në vendet e zhvilluara si USA & EU.

Në dispozicion për t'ju përgjigjur interesit tuaj,

Me Respekt,

Për **Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë (NAREA)**,

Drejtori Ekzekutiv

Reinaldo Pipiria